

# Kosova

## Indeksi i Kapitalit Njerëzor

### INDEKSI I KAPITALIT NJERËZOR DHE KOMPONENTËT E TIJ

IKNJ-ja mat sasinë e kapitalit njerëzor që një fëmijë i lindur sot mund të presë të arrijë deri në moshën 18 vjeçare. Ky indeks përcjell produktivitetin e gjeneratës së ardhshme të punëtorëve krahasuar me standardin e arsimit të përfunduar dhe shëndetit të plotë. Indeksi është ndërtuar për 157 vende.

Ai përbëhet nga pesë tregues: probabiliteti i mbijetesës deri në moshën pesë vjeç, vitet e pritshme të shkollimit të fëmijës, rezultatet e testimit të harmonizuar si një masë e cilësisë së të nxënësve, shkalla e mbijetesës së të rriturve (pjesa e 15-vjeçarëve që do të mbijetojnë deri në moshën 60 vjeç), dhe përqindja e fëmijëve që nuk janë të vonuar.

Globalisht, 56 për qind e të gjithë fëmijëve të lindur sot, kur të rriten do të jenë, në rastin të mirë, vetëm 50% produktivë nga sa do të mund të ishin; dhe 92 për qind kur të rriten do të jenë, në rastin të mirë, vetëm 75% produktivë nga sa do të mund të ishin.


### CILA ËSHTË GJENDJA E KAPITALIT NJERËZOR NË KOSOVË?

- **Indeksi i Kapitalit Njerëzor.** Një fëmijë i lindur në Kosovë sot, do të jetë **56 për qind** po aq produktiv kur të rritet saç do të ishte po të merrte arsimim të plotë dhe të gëzonte shëndet të plotë.
- **Probabiliteti i mbijetesës deri në moshën 5 vjeç.** **99** nga 100 fëmijë të lindur në Kosovë mbijetojnë deri në moshën 5 vjeç.
- **Vitet e pritshme të shkollimit.** Në Kosovë, një fëmijë që fillon shkollën në moshën 4 vjeç mund të presë që të kryejë **12.8** vite shkollë deri në ditëlindjet e vet të 18-të.
- **Rezultatet e testit të harmonizuar.** Nxënësit në Kosovë marrin **375** pikë në një shkallë ku 625 paraqet arritje të përparuar dhe 300 paraqet arritjen minimale.
- **Vitet e shkollimit të përshtatura për të nxënësit.** Duke faktoruar atë që fëmijët mësojnë në të vërtetë, vitet e pritshme të shkollimit janë vetëm **7.7** vjet.
- **Shkalla e mbijetesës së të rriturve.** Në Kosovë, **91 për qind** e 15-vjeçarëve do të mbijetojnë deri në moshën 60 vjeç. Kjo statistikë është një mjet për gamën e rezultateve fatale dhe jo-fatale të shëndetit që një fëmijë i lindur sot do të përjetonte si i rritur në kushtet aktuale.
- **Rritje e Shëndetshme (Shkalla e jo të vonuarve).** Të dhënat për të vonuarit nuk janë në dispozicion për Kosovën.

### A KA DALLIME GJINORE NË IKNJ?

Në Kosovë, IKNJ-ja për vajzat është më e lartë se për djemtë. Tabela 1 tregon zbrërthimin gjinor për secilin prej komponentëve të IKNJ-së.

Figura 1. IKNJ dhe komponentët



Shënim:


- Rrethi i madh përfaqëson Kosovën
- Rrathët e vegjël përfaqësojnë vende të tjera
- Linjat e trasha, vertikale dhe ngjyra e rrathëve reflektojnë kuartilet e shpërndarjes

Rezultatet e testit të harmonizuar	369	381	375
Vitet e shkollimit të përshtatura për	7.6	7.8	7.7
Shkalla e kështimit nën rumbullagosuri me all tona			
Shkalla e jo të vonuarve	-	-	-

Shënim:

- Kur përdoret, viza ndarëse tregon se nuk ka të dhëna të disponueshme
- Të gjitha vlerat janë të rumbullakosura
- IKNJ-ja e zërthyer sipas gjinisë llogaritet duke përdorur vetëm normat e mbijetesës për të rritur, nëse nuk disponohen të dhënat për të vonuarit të zërthyer sipas gjinisë

Figura 2. Standardet e IKNJ-së




Shënime:  
 - Nëse nuk specifikohen, të gjitha të dhënat janë për vitin 2017  
 - Intervalele e pasigurisë (linjat vertikale të zeza) pasqyrojnë pasigurinë në matjen e komponentëve të Indeksit

SI KRAHASOHET KOSOVA?

Në vitin 2017, IKNJ-ja e Kosovës është më e ulët se mesatarja për rajonin e saj, por më e lartë se mesatarja për grupin e saj të të ardhurave.


Figura 3. Hendeku i të nxënit 15



SA MËSOJNË FËMIJËT NË SHKOLLË?

Fëmijët në Kosovë mund të presin të kryejnë **12.8** vjet shkollim parafillor, fillor dhe të mesëm deri në moshën 18 vjeç. Sidoqoftë, kur vitet e shkollimit përshtaten për cilësinë e të nxënit, kjo është e barabartë vetëm me **7.7** vjet: hendeku i të nxënit prej **5.1** vjetësh (Figura 3).

Figura 4. treguesi i Kapitalit Njerëzor kundrejt BPV-së për kokë 1



A ËSHTË IKNJ-ja E KOSOVËS NË PËRPUTHJE ME ÇKA PRITET PËR NIVELIN E SAJ TË TË ARDHURAVE?

Në vitin 2017, IKNJ-ja për Kosovën është afërsisht sa pritej për nivelin e saj të të ardhurave (Figura 4).

PROJEKTI I KAPITALIT NJERËZOR

Projekti i Kapitalit Njerëzor synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të rrisë kërkesën për ndërhyrje për ndërtimin e kapitalit njerëzor.

Ai synon të përshpejtojë investime më të mira dhe të shtuara në njerëz. Projekti ka tre elemente: (i) Indeksit e Kapitalit Njerëzor, (ii) një program për të forcur hulumtimet dhe matjet në kapitalin njerëzor; dhe (iii) mbështetjen e vendeve për të përshpejtuar përparimin në rritjen e rezultateve të kapitalit njerëzor.

Për më shumë informacion mbi Projektin e Kapitalit Njerëzor ju lutemi vizitoni

[www.worldbank.org/humancapitalproject](http://www.worldbank.org/humancapitalproject)

#investimnëNjerëz